

Miratohet vendimi për Krijimin e Bazës Shtetërore për Studentët Shqiptarë Jashtë Vendlindit



Me propozimin e Ministrisë së Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin Nr. 504, datë. 24.6.2020 për "Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të studentëve të cilët studiojnë jashtë vendlindit dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare të cilët përfitojnë bursa nga Shqipëria". Ky vendim parashikon krijimin e një baze të të dhënave shtetërore për të gjithë studentët shqiptarë jashtë vendlindit si dhe të shtetasve të huaj me origjinë shqiptare të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë. Kjo bazë do të përmbajë të dhënat personale për: shtetasit shqiptarë të cilët kryejnë studimet universitare jashtë vendlindit; shtetasit e huaj me origjinë shqiptare të cilët janë përfitues të programeve të financuara nga ministria përgjegjëse për arsimin; shtetasit shqiptarë të cilët kanë përfituar bursat e studimit të cilat i ofrohen Shqipërisë nga shtete, organizata ndërkombëtare dhe jofitimprurëse në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara apo dokumente të tjera ku Qeveria e Republikës së Shqipërisë është palë. Baza e të dhënave shtetërore e studentëve shqiptarë ka si institucion administrues Agjencinë Kombëtare të Diasporës ndërsa dhënen të informacionit për të do të jenë ministria përgjegjëse për arsimin dhe ministria përgjegjëse për punët e jashtme.

Vota e Diasporës Shqiptare



Të interesuarit për të drejtën e votës në migracion, mund të gjejnë propozimet që i janë dërguar Komisionit të Reformës Zgjedhore [këtu](#).

Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko, në "Euronews Albania" diskuton për të drejtën e votës për shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë vendlindit



"Konsensusi është për të votuar me postë, pasi ka një numër të vendeve që nuk e lejojnë votimin me kuti. Dhe për të pasur një procedurë të ngjashme për të gjitha shtetet, zarfi mbetet mundësia më e mirë. Ne, në propozimet tona në KQZ, kemi kërkuar që transportimin e zarfeve të mos e bëjë posta shqiptare, por një kompani ndërkombëtare, për të shmangur paragjykimin. KQZ do të përcaktojë detajet teknike", tha z. Majko.

Aplikacioni gazeta "Diaspora Shqiptare"




App store [këtu](#); Play store [këtu](#).

U nënshkrua memorandumi mes QSPA-së dhe ASA

Në mjediset e QSPA-së, është nënshkruar memorandumi i bashkëpunimit midis Akademisë së Studimeve Albanologjike (ASA), Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) dhe Ministrisë së Diasporës. Nënshkrimi i këtij memorandumi u krye nga rektori i Akademisë së Studimeve Albanologjike, Prof. dr. Marenglen Verli, drejtoresha ekzekutive e QSPA-së, prof. Diana Kastrati, si dhe nga Ministri i Shtetit për Diasporën, Z. Pandeli Majko. Ky memorandum bashkëpunimi vjen në vazhdim të një sërë marrëveshjeve institucionale të ndërmara nga QSPA-ja, me qëllim krijimin e infrastrukturës së nevojshme për kërkimin shkencor, si dhe rritjen e kontakteve dhe literaturës së nevojshme për studimin e thelluar të historisë, kulturës dhe letërsisë arbëreshe.



"Raporto" problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#); Play store [këtu](#).

Publikohet revista elektronike e Strukturës Administrative për Diasporën dhe Migracionin në Qeverisjen Vendore



Revista e strukturës administrative për diasporën dhe migracionin në qeverisjen vendore është një botim i veçantë elektronik, i cili përmbledh aktet ligjore të miratuara lidhur me vetëqeverisjen vendore. Pjesë e kësaj reviste janë edhe Memorandumi i bashkëpunimit për bashkërendimin e punës për ngritjen e strukturës administrative për diasporën dhe migracionin në qeverisjen vendore dhe Harta administrative territoriale e qarqeve të Shqipërisë.

Platforma Digjitale e Veprave Shqiptare



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen.

Anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës zhvilluan një mbledhje online mbi të drejtën e votës me Kryeministrin, z. Edi Rama

Anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës (KKD) zhvilluan një mbledhje online me Kryeministrin, z. Edi Rama, për të diskutuar mbi të drejtën e votës për shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë vendlindit. Që prej krijimit të Këshillit, anëtarët e tij kanë bashkëpunuar dhe janë angazhuar vazhdimisht për çështjet që kanë të bëjnë me përfaqësimin e interesave të shqiptarëve të larguar nga vendlindja dhe forcimin e marrëdhënieve të tyre me Shqipërinë. Sipas rendit të ditës, diskutimi u hap nga Kryeministri, i cili theksoi angazhimin e Qeverisë për të punuar për garantimin e votës për shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë vendlindit. Mbledhja vijoi me diskutimin e Kryetarit të KKD-së, z. Mark Gjonaj, dhe Ministrisë së Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko. Ministri Majko u shpreh se maxhoranca ka vullnetin e plotë për sigurimin e të drejtës së votës për të gjithë shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë, e cila është një e drejtë kushtetuese. Më pas, mbledhja vijoi me diskutimet e anëtarëve të KKD-së mbi mundësinë e kontributit të kësaj strukture në procesin e garantimit të votës.



Bashkëpunim Ndërinstitucional për Studimin e Historisë së Arbëreshëve mes QSPA-së dhe Institutit të Historisë, Prishtinës

Arbëreshët e Zarës në Qendër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes QSPA-Së dhe Institutit Arkeologjik të Kosovës



Drejtoresha ekzekutive e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA), prof. Diana Kastrati në përmblyllje të vizitës zyrtare në Prishtinë, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi edhe me Institutin Arkeologjik të Kosovës, i cili njihet si një ndër institucionet më të rëndësishme të Trashëgimisë Kulturore të Kosovës, dhe institucioni kryesor për shkencën e arkeologjisë në këtë vend. Takimi dhe firmosja e marrëveshjes së bashkëpunimit u zhvillua në zyrën e Drejtorit të Institutit Arkeologjik të Kosovës, Z. Enver Rexha. Drejtori Rexha shprehu vlerësimin për punën e denitashme të QSPA-së dhe ndër të tjera, informoi se dy nga punonjësit shkencorë të institucionit që ai drejton, po kryejnë studimet doktorale në Universitetin e Zarës për Antropologji fizike, gjë që mund të ndikojë në forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me Arbëreshët e Zarës.



Lidhet marrëveshja e bashkëpunimit mes Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) dhe Institutit të Historisë "Ali Hadri", Kosovë. Marrëveshja u nënshkrua në mjediset e Institutit të Historisë në Prishtinë mes drejtorit të këtij institucioni, Dr. Sabit Syla dhe drejtoreshës ekzekutive të QSPA-së, prof. Diana Kastrati. Në qendër të kësaj marrëveshjeje është shkëmbimi i literaturës shkencore, si dhe hartimi i projekteve të përbashkëta akademike në realizimin e hulumtimeve shkencore dhe në organizimin e veprimtarive të ndryshme mbi Arbëreshët.

Bashkëpunim Ndërakademik mes QSPA-së dhe Universitetit të Prishtinës

Drejtoresha Ekzekutive e QSPA-së, prof. Diana Kastrati ka zhvilluar një takim zyrtar me drejtorin e Bibliotekës së Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës (ASHAK), Z. Hilmi Zogjani. Takimi është mbajtur në kuadër të vënies në zbatim të memorandumit të bashkëpunimit mes Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) dhe ASHAK-ut, ku një nga pikat kryesore të bashkëpunimit lidhet me shkëmbimin e botimeve shkencore ndër-institucionale. Z. Zogjani, pas një prezantimi të detajuar të botimeve ndër vite, ka vënë në dispozicion një listë të plotë të librave studimorë të këtij institucioni, në mënyrë që të përzgjidhen të gjithë titujt e librave mbi Arbëreshët, apo mbi aspekte që ndihmojnë në metodologjinë e punës dhe formimin e përgjithshëm akademik.

